



"TURIZMI NE EVROPEN JUGLINDORE ZHVENDOSËT LOKALISHT"

DOKUMENTI STRATEGJIK I NALAS



Network of Associations of Local
Authorities of South-East Europe





DOKUMENTI STRATEGJIK I NALAS “TURIZMI NE EVROPEN JUGLINDORE ZHVENDOSET LOKALISHT”

VIZIONI:

Komunat dhe Bashkitë e menaxhojnë turizmin në mënyrë të qëndrueshme në mënyrë që të përmbushin 3 vlera:

- *Popull dhe turistë të lumtur,*
- *shpërndarje e drejtë e shpenzimeve të turizmit dhe*
- *kujdes cilësor ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore.*



NALAS

Qëllimi i këtij Dokumenti Strategjik është për a) të ndërtuar një kuptim të përbashkët të asaj që është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në nivel lokal në Evropën Juglindore (EJL); b) të inkurajojë planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në të gjithë Evropën Juglindore përmes shfrytëzimit të potencialit të Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore (NALAS); c) të ndërtuar një pikë të përbashkët referimi për komunat lokale dhe shoqatat e pushtetit vendor (NJQV), duke e identifikuar turizmin si një opsion të rëndësishëm ekonomik që, në mënyrë që të jetë i suksesshëm, duhet të planifikohet me kujdes dhe menaxhohet për përdorim të vazhdueshëm në të ardhmen, ndërkohë që sjell përfitime edhe në të tashmen.

Duke u bazuar në mundësitë e ofruara nga rritja e qëndrueshme e turizmit ndërkombëtar, Dokumenti Strategjik paraqet vizionin, parimet e përgjithshme, objektivat, veprimet dhe rekomandimet për të nxitur zbatimin e politikave të shëndosha nga ana e komunave dhe NJQV-ve. Ai gjithashtu përpiket të ndihmojë NALAS për të shpërndarë praktikën e saj në të gjithë Evropën Juglindore në përputhje me parimet e saj të promovimit të procesit të decentralizimit në Evropën Juglindore dhe kryerjen e nismave rajonale.

Ky dokument pranon se zhvillimi i turizmit është një aktivitet shumë-sektorial që ndodh kryesisht në nivel lokal dhe ndikim social, ekonomik dhe mjedisor. Këto të fundit kërkojnë planifikim të konsiderueshëm për të bërë rezultatet e zhvillimit, tërheqës për turistët duke qenë ndërkohë edhe “i qëndrueshëm”, faktor i cili kërkon një bashkëpunim të kujdesshëm dhe bashkërendim të dy sektorëve publik dhe privat.

Veçanërisht, tri janë vlerat që duhet të plotësohen në zhvillimin e turizmit lokal. Së pari, ai duhet të marrë parasysh në mënyrë të barabartë nevojat e komuniteteve lokale dhe vizitorëve. Qëndrueshmëria afatgjatë ka nevojë për vizitorë të kënaqur që kthehen dhe të cilët rekomandojnë të tjerët për të vizituar, që do të thotë se përcjellin një eksperiencë e cila i plotëson ose i tejkalon pritjet. Megjithatë komunitetet lokale mund të kenë nevojë të përmbushin një numër kostosh të jashtme të lidhura me turizmin, prandaj është e rëndësishme që politika të kërkojë maksimizimin e kthimit ekonomik për komunitetin.



Së dyti, ai duhet të forcojë numrin dhe cilësinë e punëve lokale të krijuara dhe mbështetura nga turizmi drejtpërdrejt dhe tërthorazi, ndërkohë që kërkon edhe një shpërndarje të gjerë dhe të drejtë të përfitimeve ekonomike dhe sociale, duke përfshirë përmirësimin e mundësive, të ardhurave dhe shërbimeve në dispozicion të anëtarëve më pak të privilegjuar të komunitetit . Kjo duhet të arrihet me angazhimin dhe fuqizimin e NJQV-ve në planifikim dhe vendimmarrje lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e ardhshëm të turizmit.

Së fundi, zhvillimi i turizmit duhet të respektojë dhe të rrisë trashëgiminë historike, kulturën autentike, traditat dhe dallimet dhe vecantitë e komuniteteve pritëse, duke ruajtur gjithashtu dhe rritjen e cilësisë së peizazheve, si urbane dhe rurale, dhe të shmangi degradimin fizik dhe pamor të mjedisit. Evropa Juglindore është një hapësirë kulturore e vjetër mijëvjeçare, ku historia dhe kujtesa e përbashkët e një grupi gjeografikisht të afërt të vendeve të saj, gjeneroi një trashëgimi të shquar kulturore dhe natyrore. Ky “thesar” përfshin trashëgiminë e prekshme të tillë si ndërtesat dhe objektet historike dhe të paprekshme si traditat kulturore. Konservimi i të dyjave këtyre të fundit ka rëndësi të madhe për rritjen e qëndrueshme të sektorit të turizmit. Një angazhim rajonal dhe një qasje e përbashkët për ruajtjen e aseteve të prekshme dhe të paprekshme, kulturore dhe natyrore është arsye thelbësore për të adresuar me sukses zhvillimin e turizmit dhe për të krijuar një dialog pjellor dhe një rritje të qëndrueshme në të gjithë rajonin.

2

TURIZMI - MUNDËSITË DHE KUSHTET AKTUALE PËR ZHVILLIMIN LOKAL NË EJL

Turizmi ka qenë prej kohësh i një rëndësie të madhe në nivel global. Sipas Barometrit të fundit UNWTO Botëror të Turizmit, mbërritja e turistëve ndërkombëtar u rrit me 4% në vitin 2012 në vlerën 1.035 miliard. Parashikimi afatgjatë po përmirësohet dhe pritet që rritja të vazhdojë për të kapur shifrën 1.8 miliard deri në vitin 2030, me numër në rritje me një mesatare prej 3,3% në vit.

Veçanërisht mbërritjet ndërkombëtare në destinacionet e vendeve në zhvillim pritet të vazhdojnë të rriten me ritëm të dyfishtë (+ 4,4% në vit) nga (+ 2,2% në vit). Në terma absolutë, ekonomitë në zhvillim do të fitojnë një mesatare prej 30 milion të ardhurish në vit, në krahasim me 14 milion në destinacionet tradicionale të ekonomive të zhvilluara të Amerikës së Veriut, Evropës dhe Azisë dhe në Paqësor.

20 vitet e ardhshme pritet një rritje e vazhdueshme për sektorin duke i ofruar mundësi të pafundme ekonomive të vendeve të EJL-së aq sa mund të nxisin rritjen ekonomike, progresin shoqëror dhe qëndrueshmërinë e mjedisit, përmes ofrimit të një modeli të ri të shoqërisë dhe rritje të cilësisë së jetës.

Megjithëse vendet e EJL kanë dallime të mëdha në të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me turizmin, me destinacione bregdetare që përbëjnë pjesën më të gjerë të tregut, tendenca në turizmin ndërkombëtar dhe rritje të parashikimeve në mbarë botën të ndërtuara për të gjithë zonën së bashku me trendin e përhapur drejt turizmit alternativ dhe interesave të veçanta, rriten gjithashtu shanset për zhvillim të ndjeshëm për destinacione të brendshme.



Turizmi nuk mbështet vetëm vende pune në akomodim dhe shërbime të ngjashme të turizmit por edhe indukton një treg për mallrat dhe shërbimet në sektorë të ndryshëm si transporti, shitjet me pakicë, ndërtim, kulturë, përpunimin e ushqimit, peshkim dhe bujqësi. Ndryshe nga sektorë të tjerë, turizmi është një industri e burimeve ku “raison d’être” e tij është që të konsumohet aty ku është prodhuar. Destinacionet ekzistojnë vetëm në sajë të njerëzve që i vizitojnë ato dhe duke vënë në dispozicion në nivel lokal një amalgamë të resurseve që përbëjnë “përvojat turistike”, ai është produkti i turizmit i dorëzuar nga destinacioni dhe i konsumuar nga turistët:

- *Burime në formën e atraksioneve fizike dhe kulturore për të nxitur njerëzit për të vizituar.*
- *Burime në formën e objekteve dhe shërbimeve, duke përfshirë burimet njerëzore, që u mundësojnë atyre të qëndrojnë në destinacion.*
- *Burime në formën e infrastrukturës dhe shërbimeve që e bën destinacionin të arritshëm si dhe atraksione të ndryshme, objekteve dhe shërbimeve brenda destinacionit.*
- *Informacion i disponueshëm në mënyrë që konsumatori të ketë njohuri për destinacionin dhe burimet e tij.*

Prandaj vendimet për zhvillimin e turizmit duhet të merren në nivelin më të ulët të qeverisjes dhe aty ku është e përshtatshme të merren vendime në nivel qendror, si dhe aktorët vendorë të prekur nga turizmi duhet të konsultohen dhe të inkurajohen të marrin pjesë. Ndaj dhe është veçanërisht e rëndësishme të ketë:

- *angazhim të plotë të komunitetit lokal në zhvillimin e politikave dhe planeve të turizmit. Kjo duhet të përfshijë institucionet e qeverisjes lokale dhe duhet të jetë një proces i konsultimit të gjerë dhe pjesëmarrje për komunitetin dhe palët e tjera.*
- *fuqizim i komunitetit lokal për të ndikuar vendimet për zhvillimin e turizmit në zonën e tyre, duke përfshirë sigurimin e aftësive dhe njohurive që njerëzit kanë nevojë për të marrë pjesë në mënyrë efektive në vendimmarrje në nivel lokal.*

Për shkak të varësisë në rrethanat lokale, nuk ka marrëveshje të caktuar se cilat janë metodat më të mira ose cili është roli i njërive vendore. Disa aktorë privat dhe publik dhe disa organizata multi-qeveritare janë në mënyrë tipike të përfshira në ndërtimin dhe dorëzimin e “përvojës së turizmit”, me funksionet e marketingut të luajtura nga organizatat e menaxhimit të destinacionit ose organizata turistike rajonale, ndërsa planifikimi i destinacionit është ndërmarrë zakonisht nga një kombinim i organeve të planifikimit urban dhe rajonal.

Kjo situatë do të thotë se planifikimi i destinacionit dhe zhvillimi ndodh në një grup kompleks të anganzhimeve institucionale publike dhe private që përfshijnë organizata të ndryshme, duke përfshirë edhe ato jo-qeveritare. Analiza e palëve të interesuara e kryer nga NALAS ka ndihmuar për të identifikuar të paktën grupet e mëposhtme:

- *Në nivel lokal: kryetari i komunës/bashkisë, këshilli përkatës, këshilli i turizmit lokal, këshillat lokale për zhvillim të qëndrueshëm (komitetet), këshillat e qarqeve, agjencitë e menaxhimit të destinacionit dhe OJQ-të.*
- *Në nivelin e shoqatave lokale: Menaxherët e njohurive të NALAS, Zyrtarët PR, drejtorët ekzekutivë.*
- *Në nivel kombëtar: Ministritë përkatëse përgjegjëse (turizëm, ekonomi, etj), Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Financave, Ministria e Transportit, këshillat kombëtarë për zhvillim të qëndrueshëm dhe zyrat doganore.*
- *Në nivelin e sektorit privat: dhoma e tregtisë, shoqatat e guidave turistike, shoqatat e hoteleve dhe restoranteve, shoqata e agjencive kombëtare turistike, agjencitë publicitare, agjencitë e licencuara turistike, mjetet e komunikimit masiv, universitete të turizmit dhe të bashkimit të punëdhënësve.*
- *Në nivel ndërkombëtar: agjencitë ndërkombëtare dhe evropiane, Komisioni Evropian, dhomat kombëtare të tregtisë së vendeve përveç EJL, ANCI, CIFCA, Shoqata Kombëtare franceze e Qyteteve dhe Rajoneve të artit dhe historisë dhe qytezat me zonat e mbrojtura, rrjetet e biodiversitetit, organizatat e zhvillimit të qëndrueshëm.*





Sido të jetë sistemi i qeverisjes, planifikimi për turizëm të qëndrueshëm duhet të ofrojë një përzierje të balancuar mes qëllimeve sociale, mjedisore dhe ekonomike. Ideja e konkurrencës dhe planifikimit strategjik duhet të ndiqet gjithashtu, duke sjellë së bashku palët e interesuara dhe duke bërë analiza efektive, montim të qëllimeve dhe objektivave të matshme, së bashku me një strategji të qartë të zbatimit, të ndërtuar mbi treguesit përkatës për qëndrueshmëri në të cilën aktorët përcaktohen sipas rëndësisë së tyre dhe sipas mënyrës si duhen interpretuar rezultatet.

Qasja publike-private, në bazë të qëllimeve të qarta, objektivave dhe treguesve gjithashtu do të mundësojë caktimin e prioritetëve në investime, politikave të shëndosha fiskale dhe mbledhjen efektive të fondeve nga njësitë vendore. Kjo do të ndihmojë në zgjidhjen e paradokseve të brendshme që përmban industria e turizmit, në veçanti lidhur me financimin e projekteve të turizmit. Rezultatet e turizmit sjellin rritjen e shpenzimeve në komunitet dhe shpesh rritjen e punësimit, e cila është zgjeruar nga efekti “shumëzim”. Mirëpo edhe pse mund të jetë në interesin kombëtar për të prodhuar të ardhura në formën e taksave mbi fitimin, taksave të punonjësve, akcizat, dhe kështu me radhë, kjo nuk mund të ndihmojë autoritetet lokale, aty ku ata duhet të ofrojnë shpenzime shtesë për shkak të dispozitës së shërbimeve turistike kolektive lokale. Këto përfshijnë kostot direkte për shkak të grumbullimit të mbeturinave, promovimit, menaxhimit të muzeve dhe sigurimit të informacionit, por edhe investime të mëdha kapitale në infrastrukturë dhe super-strukturë, për aq sa zhvillimet turistike të kenë sukses dhe çështjet e qëndrueshmërisë fizike zakonisht rriten.

Çështja e financave për këtë arsye është thelbësore për turizmin e qëndrueshëm. Njësitë vendore duhet të luftojnë për rritjen e federalizmit fiskal për të mbështetur shërbimet kolektive të turizmit dhe investimeve, zbatimin e skemave të partneritetit publik-privat dhe qasjen në fondet kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla si fondet strukturore të BE-së. Fonde të tilla duhet gjithashtu të drejtohen për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve në fushën e qëndrueshmërisë, duke përfshirë të dy operatorët privat dhe publik në nivel lokal.

3

PARIMET DHE OBJEKTIVAT

Parimet e përgjithshme në vijim duhet të udhëheqin qasjen ndaj turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në nivel lokal:

- *Zhvillimi i turizmit duhet të planifikohet me një vizion afatgjatë, duke shmangur qasjet afatshkurta dhe zgjidhjet që nuk mund të jenë të qëndrueshme me kalimin e kohës.*
- *Duhet t'i kushtohet e njëjta vëmendje aspekteve ekonomike, sociale, kulturore, mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.*
- *Politikat e turizmit E.JL duhet të konsiderojnë shqetësimet etike dhe aktivitete në nivel lokal.*
- *Ndikimi i rëndësishëm i turizmit dhe industrive të tjera si dhe aktiviteteve mbi mjedisin vendor dhe komunitetit të të ftuarve, duhet të njihet, me referencë ndaj ndikimeve të tërthorta e të drejtpërdrejta si dhe efektit shumëzues.*
- *Duhet të ndërmerret vlerësim dhe gjykim objektiv i ndikimit të zhvillimit potencial turistik dhe i gjithë veprimtarisë së vazhdueshme të turizmit, në bazë të qëllimeve të zgjuara dhe objektivave të matshme të ndërtuara mbi treguesit përkatës për qëndrueshmërinë.*
- *Përfituesit e drejtpërdrejtë të turizmit, duke përfshirë bizneset dhe turizmin, duhet të bëhen të vetëdijshme ndaj kostove të jashtme në nivel vendor të lidhura me aktivitetet e tyre në mënyrë që të kontribuojnë në zbutjen e tyre.*
- *Ngritja e kapaciteteve me komunitetet lokale, e bazuar në parimin e ndihmës më mirë se të qenit urdhërues, duhet të promovohet si një komponent i rëndësishëm i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.*
- *Bashkëpunimi i ngushtë dhe i rregullt mes autoriteteve lokale të vendeve të E.JL duhet të nxitet më tej përmes rrjetit, shkëmbimit të njohurive dhe strategjive të përbashkëta, veprimeve dhe projekteve që kanë për qëllim adresimin e sfidave të turizmit dhe kapjen e mundësive.*
- *Angazhimi intensiv me vendet dhe institucionet europiane, përfshirë shoqatat kombëtare të autoriteteve lokale, duhet të promovohet dhe mbështetet.*
- *Shoqatat duhet të inkurajojnë dhe lehtësojnë shkëmbimin e praktikave më të mira në turizmin e qëndrueshëm, brenda vendeve të Evropës Juglindore dhe në një nivel mbarë evropian.*

4

VEPRIME & REKOMANDIME

Veprimet dhe rekomandimet në vijim janë dhënë për të siguruar angazhimin e duhur të të katër niveleve të palëve të interesuara në lidhje me turizmin e qëndrueshëm.

4.1. Qeveritë lokale duhet të sigurojnë:

- *Zbatimi i planifikimit sistematik strategjik dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, i cili do të përfshijë:
 - » *kontrollin e vëllimit, natyrën dhe vendndodhjen e zhvillimit të turizmit në mënyrë që të parandalojë prisionin e padrejtë ndaj resurseve lokale dhe biodiversitetit*
 - » *mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nga kontrollet e rregullta të planifikimit dhe kapacitetit të mjaftueshëm të menaxhimit*
 - » *Promovimi i organeve të menaxhimit të partneritetit të destinacionit, duke sjellë së bashku publikun, operatorët privatë dhe shoqërinë civile, përfshirë organizatat që përfaqësojnë interesat mjedisore, kulturore dhe lokal e të komunitetit.**
- *Të përfshijnë përfaqësuesit e komuniteteve lokale dhe të nxisin konsultimin dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara për të identifikuar përparësitë dhe treguesit e qëndrueshmërisë, me mjete të qeverisjes së zgjuar për të ndihmuar në trajtimin e objektivave konfliktuale, për të fituar angazhimin për zbatimin efektiv të vendimeve, të komunikojnë në mënyrë më efektive për vendimet dhe rreziqet lidhur me mundësitë e zhvillimit të turizmit.*
- *Të vënë në zbatim një sistem të matjes dhe menaxhimit të performancës së turizmit të qëndrueshëm, të orientuar në mënyrë strategjike, të përzgjedhur dhe menaxhuar sipas çështjeve prioritare të identifikuara në destinacion.*

- Të miratojnë një sistem realist të objektivave të qëndrueshmërisë, treguesit dhe matjeve në të gjitha planet e zhvillimit direkt dhe indirekt të lidhura me turizmin dhe të kryera nga qeveria lokale, duke përfshirë përdorimin e tokës dhe zhvillimin e infrastrukturës.
- Të ndërmarrin veprimtari për ngritjen e kapaciteteve, shpërndarjen e praktikave të mira dhe krijimin e rrjeteve të palëve të interesuara, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, binjakëzimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në Evropën Juglindore dhe me partnerët evropianë për të trajtuar sfidat e qëndrueshmërisë së turizmit.

4.2. Qeveria qendrore duhet :

- Të përfshijë çështjet e qëndrueshmërisë në strategjinë e saj kombëtare dhe rajonale, të cilat duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e palëve të interesuara, të nxisin respekt duke planifikuar për turizmin në nivel lokal, të reflektojnë qëllimet dhe parimet për turizmin e qëndrueshëm.
- Të pranojnë se për të pasur rezultate efektive, politikat e turizmit të qëndrueshëm duhet të zhvillohen dhe zbatohen në nivel kombëtar dhe lokal, në këtë të fundit luajnë një rol të rëndësishëm dhe strukturat administrative, siç vërtetohet nga praktika e disa vendeve që janë në proces të decentralizimit politik të tyre.
- Të plotësojnë strategjitë kombëtare dhe rajonale të turizmit me ato që kryhen në nivel lokal, promovimi i bashkëpunimit efektiv në planifikimin dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në lidhje me programet që lidhen me fondet strukturore të BE-së, duke siguruar se kriteret e qëndrueshmërisë janë të përfshira në disbursimin e fondeve për të mbështetur zhvillimin e turizmit.
- Të përfshijnë aktivisht autoritetet lokale në krijimin dhe zbatimin e projekteve të turizmit të qëndrueshëm, në mënyrë që të pranohen inputet dhe të garantohet kontrolli me bazë të gjerë i komunitetit në zhvillimin e turizmit, në respekt të parimeve të qëndrueshmërisë dhe subsidiaritetit; bordet turistike lokale duhet të marrin rolin e ndërmjetësve dhe të veprojnë si koordinatorë kryesorë në këtë proces, dhe aty ku nuk janë parashikuar ende komizat institucionale, duhet të themelohen në nivel komunal.





4.3. Komuniteti i biznesit duhet të:

- *Shmangë turizmin jo-etik, duke siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve dhe të punojë në drejtim të eliminimit të të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe punës në udhëtim dhe turizëm.*
- *Të miratohen parimet e turizmit të qëndrueshëm dhe veçanërisht të:*
 - » *Të ofrojnë shërbime me cilësi të qëndrueshme, duke u përqëndruar në produkte, shërbime dhe aktivitete të një cilësie të lartë.*
 - » *Trajtojnë punonjësit e tyre në mënyrë të drejtë, duke respektuar të drejtat e tyre dhe ato të organeve të tyre përfaqësuese.*
 - » *Zbatimi i sistemeve të menaxhimit të mjedisit, përfshirë stafin dhe informimin e turistëve.*
 - » *Mbështetje në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore lokale.*
 - » *Rekrutimi i stafit dhe furnizimi me burime në nivel lokal kur është e mundur, dhe angazhimi me komunitetin dhe vënia e mjediseve në dispozicion të tyre.*
 - » *Pjesëmarrja në mbledhjen e të dhënave dhe monitorimit dhe të jenë të përgatitur për të matur dhe për të raportuar për performancën e tyre.*
- *Të bashkëpunojë me qeveritë vendore në planifikimin e turizmit dhe zhvillimit, ndërkohë që mbështesin dhe marrin pjesë në destinacionet partnere.*
- *Promovimi i përdorimit të skemave të certifikimit dhe dhënies së çmimeve, mbi bazën e kritereve të qëndrueshmërisë, dhe krijimin e grupimeve apo rrjeteve, të bazuara gjeografikisht apo tematikisht, që promovojnë standarde të përbashkëta, mbështetje të ndërsjellë dhe konkurrencë mes anëtarëve.*

Ky Dokument Strategjik është pregatitur nga Task Force për Turizëm të Qëndrueshëm pranë NALAS me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Komunave Italiane (ANCI).

Anëtarë të Task Force për Turizëm të Qëndrueshëm pranë NALAS:

Abdalajbegovic Dzenana, nga Shoqata e Bashkive dhe Qyteteve të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës

Akinci İlkey, nga Unioni i Bashkive të Marmara

Coku Iva, nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Grujic Sladjana, nga Konferenca e Qyteteve dhe Bashkive të Serbisë

Kek Sasa, nga Shoqata e Qyteteve dhe Bashkive të Sllovenisë

Kos Marko, nga Shoqata e Bashkive të Republikës së Kroacisë

Kupusija Amir, nga Shoqata e Bashkive dhe Qyteteve të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës

Lazarevic Sladjana, nga Shoqata e Bashkive dhe Qyteteve të Republikës Srpska

Luncasu Irina, nga Kongresi i Autoriteteve Vendore të Moldavisë

Miroiu-Lamba Adrian, nga Shoqata e Komunave të Rumanisë

Mrvaljevic Darko, nga Shoqata e Bashkive të Malit të Zi

Petkov Simeon, nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Republikës së Bullgarisë

Sabani Sara, nga Shoqata e Njësive të Vetqeverisjes Vendore të Republikës së Maqedonisë

Elena Sherifi, nga Shoqata e Komunave të Shqipërisë

Me mbështetjen e:

Formato Roberto, ekspert i Turizmit të Qëndrueshëm, Shoqata Kombëtare e Komunave Italiane (ANCI).

Zajazi Kelmend, Drejtor Ekzekutiv NALAS

Janevska Jelena, Menaxhere e Komunikimit dhe Njohurive NALAS

Asistentët e Menaxhimit të Njohurive NALAS

Ilijeva – Acevska Natasha, Oficere Programi për Turizëm të Qëndrueshëm

Fotot në këtë publikim janë ofruar nga:

Janevska Jelena

Acevski Goran



Network of Associations of Local Authorities of South East Europe
<http://www.nalas.eu/st/index.aspx>

